



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Dt 20.01.2023]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

OPERATORIT EKONOMIK “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK

Adresa: Tirane Rr. "Stanislav Zuber", Nd. 2, H.I9. Njesia administrative Nr. 7, 1023, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar (marreveshje kuader).**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* “Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së rrjetit në Bashkinë Tiranë” me Nr. reference REF-53970-12-16-2022 për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (*njoftim kontrate*): Buletini Nr. 176 datë 27 Dhjetor 2022

Publikimet e mëparshme (*njoftim fituesi paraprak*): Buletini Nr. 4 datë 16 Janar 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

- Operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS -IBS” sh.p.k,

NIPT J61820057C

Vlera e ofertës pa tvsh = 5,667,700 (pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind) lekë.

- **Operatori ekonomik “ITE GROUP” sh.p.k, NIPT K11323001H**

Vlera e ofertës pa tvsh = 5,667,700 (pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind) lekë.

- **Operatori ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” sh.p.k, NIPT K01625001C**

Vlera e ofertës pa tvsh = 5,504,000 (pesë milion e pesëqind e katër mijë) lekë

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “ITE GROUP” sh.p.k, NIPT K11323001H**

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

- I. Referuar “Kritereve të veçanta të kualifikimit”, konkretisht:

...” Në pikën 1/b të kritereve të vecanta të kualifikimit, AK kërkon:

Në pikën 1.b, Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; ...”

Operatori ekonomik “ITE GROUP” sh.p.k, nuk ka paraqitur në SPE, *Sigurimin e Ofertës sipas Shtojcës 3.*

- II. Në pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të DT, AK kërkon:

... ” *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet*

përkatësisht 1,166,144.17 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzetë e katër pikë shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,*
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara....”*

Operatori ekonomik “ITE GROUP” sh.p.k, nuk ka paraqitur në SPE asnjë dokument në përmbushje të kriterit të sipërcituar, për të vërtetuar përvojën e mëparshme.

III. Në pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik/ Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Autoriteti Kontraktor kërkon:

” Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë:

b) Standartin ISO 27001 ose ekuivalent për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes.

c) Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 20000-1 ose ekuivalent, për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes).”

Operatori ekonomik “ITE GROUP” sh.p.k, nuk ka paraqitur në SPE asnjë dokument në përmbushje të kriterit 2.3.2/ b dhe 2.3.2/ c të Kapacitetit Teknik/ Kriteret e Vecanta të Kualifikimit.

IV. Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit teknik të Krieteve të Vecanta të Kualifikimit, AK kërkon:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim Prodhuesi ose Distributori të autorizuar për pajisjet e ofertuara (zërat 2,12 / pika 7/ Planifikimi i Buxhetit të termave të referencës). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja

midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, ëbbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.”

Operatori ekonomik “ITE GROUP” sh.p.k, nuk ka paraqitur në SPE asnjë dokument në përmushje të kriterit të sipërcituar.

V. Në pikën 2.3.4 të Kapacitetit Teknik/ Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Autoriteti Kontraktor kërkon:

“Për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, cilësinë e punës gjatë instalimit dhe konfigurimit të zërave të kërkuar si dhe për të garantuar suportin dhe garancinë përgjatë periudhës së parashikuar sipas specifikimeve teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a) *Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për siguri në rrjetat kompjuterike.*
- b) *Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për pajisje sëitch, për të mundësuar instalimet dhe konfigurimet e sëitch-eve që do të lëvrohen.*
- c) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT ose ekuivalente.*
- d) *Të paktën 1 (një) punonjës të pajisur me dëshmi të kualifikimit teknik për sigurimin teknik ose ekuivalente*

****Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.***

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- *Dëshmitë/Transkriptet përkatëse/Certifikata për specialistët e kërkuar.*
- *Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi,*

Kriteri 2.3.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit”.

Operatori ekonomik “ITE GROUP” sh.p.k, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit , pjesa III, pika B, nuk ka plotësuar informacionin e e kërkuar për stafin sipas kërkesave të kriterit 2.3.4 të Dokumentave Standarde të Tenderit.

VI. Në pikën 2.3.4 të Kapacitetit Teknik/ Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Autoriteti Kontraktor kërkon:

“Operatori ekonomik duhet që në ofertën teknike të paraqesë markën, modelin shoqëruar me katalogë ose broshura për artikujt që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të cdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për

përputhshmërine e tyre). Fleta/pjeset e katalogut/broshurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.”

Referuar kriterit të sipërcituar operatori ekonomik “ITE GROUP” sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë dokument në përmbushje të tij.

Në vijim të arsytimit, KVO gjykon se operatori ekonomik “ITE GROUP” sh.p.k, nuk ka përmbushur kërkesat sipas 1.b të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), kriterin 2.3.1, 2.3.2/b dhe 2.3.2/c, kriterin 2.3.4 dhe kriterin 2.3.5 të Kapacitetit Teknik/Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, duke e shpallur ofertë të pavlefshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

- **Operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS -IBS” sh.p.k, NIPT J61820057C**

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

- I. Në pikën 1.a të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, shtojca 7 e DST, kërkohet:

”Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8”*

Operatori Ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS -IBS” sh.p.k, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur, nuk ka plotësuar informacionin për *”personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së”*, (kërkesa ç e Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit) konkretisht ky informacion mungon në paragrafin përkatës të formularit:

...” Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

...”

- I. Në pikën 2.3.4 të Kapacitetit teknik, pjesë e Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, AK kërkon:

“Për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, cilësinë e punës gjatë instalimit dhe konfigurimit të zërave të kërkuar si dhe për të garantuar suportin dhe garancinë përgjatë periudhës së parashikuar sipas specifikimeve teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- e) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për siguri në rrjetat kompjuterike.*
- f) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për pajisje sëitch, për të mundësuar instalimet dhe konfigurimet e sëitch-eve që do të lëvrohen.*
- g) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT ose ekuivalente.*
- h) Të paktën 1 (një) punonjës të pajisur me dëshmi të kualifikimit teknik për sigurimin teknik ose ekuivalente*

****Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.***

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Dëshmitë/Transkriptet përkatëse/Certifikata për specialistët e kërkuar.*
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi,*

Kriteri 2.3.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.”

Referuar sa më sipër, Operatori Ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS -IBS” sh.p.k, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa III, Pika B e tij (Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)), nuk ka plotësuar informacionin mbi stafin dhe certifikimet përkatëse, sipas kërkesave të kriterit 2.3.4, të DST.

Në vijim të arsyetimit, KVO gjykon se operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS -IBS” sh.p.k, nuk ka përmbushur kërkesat sipas pikës ç të Kritereve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit) e cila përmbushet nëpërmjet formularit

përmbledhës të vetëdeklarimit dhe kriterin 2.3.4, të Kapacitetit Teknik, pjesë e Kritereve të Vecanta të Kualifikimit duke e shpallur ofertë të pavlefshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____